

Miftar KURTI

**PROFILI KRIJUES DHE SHKENCOR I PROFESORESHËS, I
HISTORIANES DHE I INTELEKTUALES EMINE ARIFI-BAKALLI**

Lajmi për shkuarjen në amshim të prof. dr. Emine Arifi-Bakalli (1951-2024) ishte një lajm sa i hidhur aq edhe i papritur. Prof. dr. Emine Arifi-Bakalli ishte profesoreshë ordinare në Departamentin e Historisë në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Prishtinës. Për dekada me radhë ishte mësimdhënëse në tri nivele e këtyre lëndëve: *Histori bashkëkohore shqiptare* dhe *Histori e integrimeve evropiane* (studimet baçelor), *Historiografia shqiptare shek XIX-XX*, *Histori ekonomike dhe konstitucionale shqiptare* dhe *Histori e Kosovës* (studimet master) dhe *Histori bashkëkohore e Kosovës* (studimet e doktoratës). Duke qenë eksperte për *Historinë moderne dhe bashkëkohore shqiptare*, ishte angazhuar me përkushtim në avancimin e plan-programeve për Histori në të gjitha nivelet në Degën e Historisë në frymë bashkëkohore.

Ndër të tjera ka qenë edhe kryetare e *Pleqësisë në Fakultetin Filozofik* dhe shefe e *Shkallës së Tretë të Studimeve*, anëtare e një varg këshillave organizative në tryeza, simpoziume e konferenca shkencore; anëtare e redaksive të një numri të botimeve me interes shkencor; anëtare e *Këshillit Botues të Universitetit të Prishtinës*, e *Këshillit Botues të Fondit për shoqëri të hapur-Prishtinë*, e *Këshillit për Histori në Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Kosovës*, e Grupit të Ekspertëve për Hartimin e Plan-Programave pranë Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT); e Komisionit Shkencor në MASHT, por edhe recensente e udhëheqëse (mentore) e një numri të madh të aspirantëve (kandidatëve) për tituj shkencor. Ka botuar shumë shkrime profesionale nëpër gazeta e revista. Që nga viti

1977 (kur botoi punimin e parë) e deri në librin e fundit “Drejt eliminimit të faktorit shqiptar në Ballkan”, botuar në vitin 2023 nga Instituti i Historisë-Prishtinë, ka trajtuar tema për ngjarje historike, tema që lidhen me zhvillime historike në rrafshin politik, diplomatik, madje edhe ekonomik, ka kultivuar pothuajse të gjitha zhanret e historiografisë, si: shqyrtime, vështrime, trajtesa shkencore, monografi, sinteza historiografike, kritikë historiografike dhe përkufizime teorike, të cilat i ka botuar dekada me radhë në Prishtinë e Tiranë, por jo vetëm.

Një kontribut të veçantë në fushën e historiografisë shqiptare përbëjnë katër veprat e saj: *Marrëdhëniet ekonomike shqiptaro-jugosllave 1929-1939*, Instituti i Historisë, Prishtinë, 1997; *Çështje nga historia moderne dhe bashkëkohore shqiptare*, Instituti Albanologjik, Prishtinë, 2011; *Përballje historiografike*, Instituti Albanologjik, Prishtinë, 2015; dhe *Drejt eliminimit të faktorit shqiptar në Ballkan*, Instituti i Historisë, Prishtinë, 2023. Është edhe bashkautore në disa libra. Këto dhe të tjera dëshmojnë se kemi të bëjmë me një profesoreshë, historiane, studiuese dhe një intelektuale me kontribut të veçantë dhe shumë të çmuar në jetën akademike dhe në historiografinë shqiptare; me një personalitet me biografi e bibliografi të pasur, e cila, me plotë të drejtë është përfaqësuar në *Fjalorin Enciklopedik Shqiptar*.

Prof. dr. Emine Arifi-Bakalli, sado që e ka një bibliografi shumë të pasur dhe me punime cilësore të botuara nëpër gazeta dhe revista shkencore, ajo ka botuar edhe disa vepra, por nuk ka botuar vepra shpesh, as nuk ka botuar shumë vepra: katër gjithsejtë. Nëse punimin e parë e ka botuar në vitin 1977, atëherë veprën e parë e ka botuar 20 vjet më vonë, në vitin 1997. Distanca kohore mes botimit të veprës së parë dhe veprës së dytë është 14-vjeçare, sepse të dytën e ka botuar në vitin 2011. Distanca mes të veprës së tretë dhe të dytës është 4 vjet, kurse mes të tretës dhe të katërt është 8 vjet. E katërta dhe e fundit për të gjallë të saj është botuar vitin e kaluar, më 2023. Këto distanca kohore nga një botim te tjetri flasin për kujdesin dhe përgjegjësinë e saj ndaj fjalës së shkruar, ndaj asaj që ka shkruar dhe botuar, duke i kushtuar vëmendje vazhdimisht ngritjes në cilësi e jo në sasi. Kjo flet edhe për një angazhim dhe përkushtim tjetër të saj në rrafshin intelektual, flet për angazhimin e saj si profesoreshë në Departamentin e Historisë të Fakultetit Filozofik të Universitetit të Prishtinës, ku punoi derisa u pensionua. Edhe në këtë aspekt ajo ka shpenzuar shumë kohë e mund me studentë të tri

niveleve (baçelor, master dhe doktoratë). Kjo e bën edhe më të plotë dhe më të shumanshëm profilin e saj intelektual, ngase ajo ka mentoruar qindra studentë të studimeve themelore dhe master, por edhe dhjetëra doktorantë. Si studiuese ka marrë pjesë edhe në tryeza shkencore, në sesione edhe në konferenca shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare. Përveç një numri të konsiderueshëm të punimeve të saja të botuara në gazeta dhe revista, kam arritur t'i lexoj dhe të mbaj shënim dhe tri veprat e saj të para, me dëshirën dhe shpresën që në një moment të caktuar ta shpërfaqim opinionin dhe mendimin tim për këto vepra, pa pretendimin për të bërë një vështrim kritik shterues.

Në tre librat, rreth 1 000 faqe tekst, botuara në një hark kohor prej 18-vjetësh (1997-2015), janë të shumta temat e trajtuara në veprat e saj. Të shumta dhe të larmishme. Harku kohor në të cilën shtrihen temat e trajtuara përshpikshëm shekujt XIX, XX dhe fillimishekullin XXI. Të shtrira në hapësirë e tejkalojnë gjeografinë kombëtare. Këto tre libra përbëjnë vlerë të padiskutueshme në historiografinë shqiptare, në fushën e mendimit teorik dhe kritik.

Marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave nga këndvështrimi i historianes Emine Arifi-Bakalli

“Marrëdhëniet ekonomike shqiptaro-jugosllave 1929-1939”, botuar nga Instituti i Historisë-Prishtinë, 1997, është vepra e saj e parë. Siç vërehet edhe në titull, temë bosht e kësaj vepra janë marrëdhëniet ekonomike shqiptaro-jugosllave në kontekst politik dhe historik në një periudhë dhjetëvjeçare, janë marrëdhëniet ekonomike mes dy shteteve të Ballkanit (Shqipërisë e Jugosllavisë) në një periudhë kohore aspak stabile, as në rrafshin kombëtar, as në atë ndërkombëtar. Mbase motivi kryesor mbi të cilin studiuesja e strukturon temën dhe veprën është Shqipëria dhe përpjekjet e saj për t'u konsoliduar si shtet. Një nga shtyllat kryesore në këtë drejtim ishte ekonomia. Çështjet ekonomike në raportet shqiptaro-jugosllave tejkalojnë suazat, kufijtë, kornizat e temës bosht, sepse gjatë trajtimit të kësaj problematike marrin konotacione shumë më të gjera. Shqipëria në atë kohë (e cunguar) ishte shtet në konsolidim. Bënte përpjekje të mëdha që të rimëkëmbej në aspektin social, ekonomik, infrastrukturor, politik, të sigurisë,

por edhe në marrëdhëniet ndërkombëtare.

Në të gjithë këto sfera haste në pengesa nga Italia, nga Jugosllavia, nga shtete tjera ballkanike, nga Fuqitë e Mëdha, por edhe nga faktorë të brendshëm. Këto dhe të tjera nuk lejonin që Shqipëria të konsolidohej dhe të funksiononte si shtet në asnjë sferë të jetës. E tillë shpërfaqet argumentueshëm Shqipëria në këtë libër. Marrëdhëniet ekonomike bilaterale mes Shqipërisë dhe Jugosllavisë nuk ishin normale, aspak korrekte, asnjëherë në favor të shtetit shqiptar. Nuk ishin normale, korrekte dhe asnjëherë të favorshme, sepse qëllimi i Jugosllavisë nuk ishte që të kishte marrëdhënie stabile me fqinjin e saj, aq më tepër me Shqipërinë, por bënte përpjekje të vazhdueshme ta pengonte dhe ta shantazhonte shtetin shqiptar aq sa ishte e mundur në mënyrë që të mos lejonte që ai të zhvillohej ekonomikisht, të mos konsolidohej dhe funksiononte si shtet. Ky ishte njëri synim. Synimi tjetër i Jugosllavisë ishte që përmes Shqipërisë t'i kundërvihej Italisë, e cila po ashtu, sikurse edhe Jugosllavia kishte qëllime të njëjta ndaj Shqipërisë.

Pavarësisht kësaj, Shqipëria kishte lidhur marrëdhënie me të dy shtetet, ani se që të dyja kishin synime të njëjta: që ta pengonin konsolidimin e saj si shtet. Shqipëria, nga ana e saj, ishte e detyruar të mbante marrëdhënie me të dy palët, me shpresën se do ta amortizonte ndikimin absolut të njëres apo tjetres. Pavarësisht këtyre synimeve djallëzore nga Jugosllavia dhe Italia, Shqipëria kishte krijuar marrëdhënie, por jo të favorshme. Të mira a të këqija, korrekte a jo marrëdhënie ekonomike prekën disa sfera: tregtare, bankare, minerare, veterinare, rrugore, ajrore, qarkullimit kufitar, turizmit, linjat postare e telefonike, e deri të eksporti dhe importi i mallrave. Disa prej tyre funksionuan më mirë, disa pak, e disa mbetën vetëm si ide. Ishin funksionale ato linja që më së shumti i hynin në punë Jugosllavisë, kurse ato që shkonin në interes të Shqipërisë ose funksionin pak, ose nuk funksiononin fare. Eksporti dhe importi ishte në disproporcion të madh. Jugosllavia eksportonte shumëfish më shumë, kurse Shqipëria importonte shumëfish më pak¹. Po t'i shikojmë statistikën e dhëna në këtë libër sa i përket eksportit dhe importit shqiptaro-jugosllav, sipas viteve, përgjatë një dekade të "marrëdhënieve ekonomike" hasim në të dhëna qesharake, madje edhe poshtëruese për

¹ Emine Arifi-Bakalli, *Marrëdhëniet ekonomike shqiptaro-jugosllave 1929-1939*, Instituti i Historisë, Prishtinë, 1997, 83, 85.

Shqipërinë. Një nga arsyet pse ndodhte kështu mbase mund të jetë politika e lëshimit pe e Shqipërisë karshi Jugosllavisë për shkak se ishte e pafuqishme të bënte më shumë, të vepronte ndryshe. Këto shifra, këto të dhëna statistikore dhe përqindjet kanë zënë hapësirë të dukshme në këtë libër. Ato flasin vetë se kush ishte në favor e kush në disfavor, se për çfarë marrëdhëniesh (jo)korrekte bëhet fjalë mes dy shteteve. Kjo është shpërfaqur duke pas për bazë referenca kredibile, argumente të mjaftueshme nga kjo studiuese. I përmenda këto të dhëna për t'u futur në temën, në përmbajtjen e librit.

Shikuar nga ana formale strukturore dhe kompozicionale, libri përbëhet prej pesë kapitujve, hyrjes dhe përfundimit, burimeve arkivore të pabotuara, dokumenteve të publikuara në gazeta e revista shkencore, literaturës, indeksit të emrave dhe përmbajtjes. Kjo strukturë, ana formale e librit ngërthen në vetvete të dhëna statistikore e tabelore, ato fusha e atë eksport e import nëntemash, temash e çështjeve të trajtuara, të cilat esencialisht e përbëjnë strukturën e veprës. Vepra ka rreth 260 faqe tekst. Tekstin e çdo faqeje mund ta “ndajmë” (për efekte interpretimi strukturor) në dy pjesë, si formë dhe si përmbajtje, për dy arsye. E para, ka të bëjë me tekstin në formatin real që zë faqen kryesore, ku flitet për temën bosht e shoqëruar me fusnota. E dyta, pjesa e poshtme e faqes, pra ajo që është në fusnotë. Kjo në rrafshin formal përbën një “dyzim” sa të nevojshëm aq edhe interesant, si në rrafshin përmbajtjesor dhe në atë formal, gjithashtu. Sepse tema bosht trajtohet në pjesën kryesore të tekstit, por plotësimet tematike bëhen në fusnotë përmes sqarimeve e informacioneve të nevojshme.

Te pjesa e parë (kryesore) e faqes ruhet linja e rrëfimit për temën, kurse tek e dyta (në fusnotë) janë të dhënat referenciale mbi të cilat qëndron teksti si tërësi. Sqarimet e shpeshta, informacionet, citimet e burimeve nëpër fusnota e bëjnë më të ngjeshur, më komplet e më komplekse strukturën e librit, e shtrijnë dhe e zgjerojnë temën, e dendësojnë tekstin. Siç del nga teksti dhe përmbajtja e tij marrëdhëniet Shqipëri-Jugosllavi nuk funksionuan, nuk ishin korrekte. Në fakt ishin marrëdhënie të dështuara për Shqipërinë, sepse përfitonte vetëm Jugosllavia. Kjo më së miri ilustron me një iks (X) të kuq në ballinën e librit. Në faqet e këtij libri, përveç marrëdhënieve ekonomike mes dy shteteve, gërshetohen dhe trajtohen çështje të ndryshme politike, ushtarake, diplomatike dhe strategjike kombëtare e ndërkombëtare. Veçanërisht bie në sy fakti se si kryqëzoheshin shpatat mes Italisë dhe

Jugosllavisë në dëmin e Shqipërisë; sesa kishte interes për investime në Shqipëri nga ana e kompanive botërore, pas të cilave qëndronin shtete të ndryshme, duke përfshirë madje edhe Anglinë e SHBA-në. Këto e fakte të tjera flasin qartë se Shqipëria e kohës, shteti shqiptar po pengohej nga shumë anë të konsolidohej, sidomos nga grykësitë e fqinjëve ballkanikë, e bejlerëve, agallarëve, fajdexhinjve, kumarxhinjve, borxhlinjve, krerëve të fiseve dhe bajraktarëve vendas, të cilët luftonin vetëm për interesa personale, grupore, klanore, farefisnore dhe të huaja.

Kësisoj, interesat personale, grupore, klanore e farefisnore, tendencat haxhiqamiliste, sikurse edhe veprimet jugosllave, nuk ishin më pak të dëmshme për Shqipërinë, më pak kriminale se ato të nazifashistëve para dhe gjatë LDB-së. Ky është një nga konkludimet që nxjerrë profesoresha Bakalli. Profesoresha Emine Arifi-Bakalli ka trajtuar në këtë vepër. Sepse profesoresha Bakalli ka shkruar edhe për fatin tragjik të copëtimit të trojeve shqiptare në Konferencën e Ambasadorëve në Londër.

Kjo fatkeqësi përbën një dimension tjetër trajtimi, e veçon para lexuesit edhe një aspekt tjetër, se pse Shqipëria nuk po zhvillohej e konsolidohej. Se copëtimi i trojeve shqiptare, ndarja e Shqipërisë në Konferencën e Ambasadorëve në Londër (1913) ishte tragjike, shumë e padrejtë dhe me shumë pasoja afatgjate e dëshmon një fragment që kam shkëputur nga një fusnotë në të cilën autorja citon historianin serb, Dimitrije Tucoviqin, ku me pak fjalë paraqitet fati tragjik i copëtimit të trojeve shqiptare, sepse Konferenca e Ambasadorëve në Londër, “...e ndau bujkun prej arës, bagëtinë prej kullotës, tuben prej lugjeve, katundin prej mullirit, blerësin dhe shitësin nga tregu, rrethin prej qytetit dhe tërë viset malore prej qendrës së tyre ekonomike dhe hambarët e ushqimit. Shqiptari i andejshëm nuk mund të kalonte në tokën që kishte ngelur në këtë anë. Të gjitha burimet e jetës u prenë. Populli i lodhur dhe i uritur së pari u lut që ta linin të vinte lirisht në treg, por, kur iu pre edhe kjo, atij s’i mbeti tjetër veçse vdekje prej urisë ose plumbit”². Ky fragment dëshmon më së miri se në çfarë gjendje ishte katandisur Shqipëria, se me çfarë problemesh po ballafaqohej populli shqiptar, pse shteti shqiptar nuk po zhvillohej në asnjë aspekt, pse nuk po mund të konsolidohej si shtet; se çfarë vërtet ka trajtuar në veprën e saj të parë

² Po aty, 162.

kjo historiane. Dhe sa më shumë koncentrohesh në leximin e këtij teksti aq më shumë ta shtohet kureshtja për lexim dhe rilexim.

Edhe pse kanë kaluar më shumë se dy dekada e gjysmë nga botimi, libri vazhdon të jetë ende aktual qoftë për temën, qoftë për strukturën, për qasjen, për argumentet, për sqarimet, për gjuhën e fjalorin; për burimet dhe literaturën e pasur. Në fakt burimet dhe literatura përbëjnë një vlerë të shtuar të kjo vepër, jo vetëm se ajo është e bollshme dhe reprezentative, por edhe se është vjelur nga institucione kredibile të shteteve të ndryshme, nga arkivat (ushtarake, politike, diplomatike dhe ekonomike) jugosllave, turke, londineze, parisienne; nga *Arkivi Qendror Shtetëror i Shqipërisë-Instituti i Historisë*; nga shtypi në Shqipëri (*Besa, Drita, Shtypi, Vatra, Vullneti, Arbëria, Ora, Demokracia, djersa e popullit, Leka*); jashtë Shqipërisë (*Liria kombëtare, Kuvendi Kombëtar, Albania, Shqipëria e re*); Jugosllavi (*Politika, Vreme, Vardar, Novosti (Beograd e Zagreb), Veçernja poshta, Srpski knjizhevni glasnik, Tergovinski list*); nga shtypi ballkanas, evropian e botëror. Burimet dhe literatura flasin gjithashtu se sa i pasur me burime dhe literaturë është ky libër, sa punë e madhe hulumtuese është bërë nga kjo studiuese. Mirëpo, ky nuk është libri i vetëm me të cilën profesoresha Emine Bakalli ka lënë gjurmë në historiografinë shqiptare. Ky është vetëm libri i parë, paraprijës i veprave të tjera shkencore.

Teksti në kontekst të kohës dhe të rrethanave

Vepra e dytë e historianes dhe studiuses Emine Arifi-Bakalli me titull “*Çështje nga historia moderne dhe bashkëkohore shqiptare*” është botuar në vitin 2011. Çështja e parë që më la mbresa pas leximit të kësaj vepre është fakti se janë trajtuar disa tema, temat janë gërshetuar dhe janë strukturuar në funksion të dy çështjeve kryesore: historisë dhe historiografisë. E dyta, si zhanër ky libër është i ndryshëm nga i pari, përbëhet nga një shumësi zhanresh, është përmbledhje shkrimesh të ndryshme: kumtesa, ese, vështrime e trajtesa të botuara në shtypin e kohës ose të lexuara nëpër simpoziume e konferenca shkencore. Një e veçanta tjetër, e tretë, ka të bëjë me lëndën, e cila ka një shtrirje më të madhe në kohë (mbi dy shekuj) dhe hapësirë të gjerë. Çështja e radhës është struktura dhe ana kompozicionale. Si vëllim që të dy janë përafërsisht të njëjtë, por teknikisht i dyti është i përgatitur shumë më

mirë. Është edhe më gjithëpërfshirës.

Të veçanta të tjera janë edhe shkrimet që lidhen me personalitete, me ngjarje, me vepra, histori dhe historiografi. Libri as ka hyrje, as përfundim, as strukturalisht nuk është i ndërtuara si i pari. Ka dyfish më shumë burime e literaturë. Natyrisht se nuk mungon indeksi i emrave dhe përmbajtja. Libri do të thosha fillon me *in medias res*, edhe pse hapet me një Parathënie të thukët e me karakter vlerësues dhe afirmativ të prof. dr. Ana Lalajt. Qasja ndaj trajtimit të temave është tjetër, e ndryshme. Në rrafshin formal, struktura e librit ka dy pjesë, dy shtylla të forta të ndara me tituj, që në njëfarë mënyre e përcaktojnë edhe tipin e shkrimit: *trajtesa* dhe *vështrime e vlerësime*. Këto e përbëjnë trungun, kurse 8-9 kapitujt a nënkapitujt përbëjnë degët e lidhura mirë me trungun. Temat referenciale janë personalitetet e mëdha të kulturës, historisë dhe historiografisë shqiptare, si: Naum Veqilharxhi (Naum Panajot Bredhi-M.K.), Ali Hadri, Isa Boletini, Hajdar Dushi...; ngjarjet me rëndësi e peshë kombëtare, historike, politike e diplomatike, si: Kryengritja e vitit 1910, Pushtimi i Shqipërisë nga Italia fashiste, Komiteti për Mbrojtjen Kombëtare të Kosovës, Shqipëria dhe Pakti Ballkanik, Konventa jugosllavo-turke për shpërnguljen e shqiptarëve; Gratë dhe rolin e tyre në luftën e Kosovës. Nuk mbetet anash çështja madhore e bashkimit kombëtar. Një hapësirë e veçantë është rezervuar për vështrime dhe analiza të librave që merren me opinione, pikëpamje, raportet politike, diplomatike e historike për Kosovën, me problemet, sfidat që lidhen me Kosovën si shtet, por edhe refleksionet e Kurrikulës në Kosovën e re.

Pjesa e parë e librit (*Trajtesa*) bie në sy jo vetëm për temat dhe mënyrën e trajtimit, por edhe për kohën, rrethanat dhe kontekstin e trajtimit të tyre. Shpesh tema trajtohet duke pas për bazë një ngjarje që lidhet me ndonjë datë-ditë me rëndësi historike, ndonjë personalitet gjatë historisë, me ndonjë tribunë, sesion, simpozium a konferencë shkencore për tema problemore aktuale a historike. E kësaj natyre është trajtesa për rilindësin Naum Veqilharxhi, ku shpërfaqet roli dhe kontributi arsimor, kulturor dhe historik i këtij rilindësi. Çështjet tjera të pjesës së parë trajtohen në rrafshin historik, aktual, politik, diplomatik, por edhe sociologjik. Kjo e fundit, aspekti i sociologjisë historike, përbën thelbin e trajtesës “*Konteksti politik dhe shoqëror i kryengritjes së vitit 1910*”, e cila pasohet nga eseja “*Konteksti dhe dimensionet historik i veprës së Naum Veqilharxhit...*”. Trajtesa e radhës

“Pakti Ballkanik dhe Shqipëria” mund të konsiderohet edhe një polemikë.

Autorja i kundërshton rreptë, madje i quan të painformuar ata historianë të cilët thonë se Shqipëria nuk ka shfaqur kurrfarë interesi të jetë pjesë e Paktit Ballkanik. Ajo jep të dhëna konkrete, duke përmendur vitet (1934 dhe 1936) në të cilat Shqipëria ka bërë kërkesë, por kërkesat e saj janë injoruar, janë shpërfillur. Përmenden edhe arsyet konkrete pse ndodhi një shpërfillje e tillë. Një vëmendje dhe hapësirë e veçantë në këtë libër historiania ia ka kushtuar *Konventës jugosllavo-turke për shpërngulje e vitit 1938 në funksion të spastrimit etnik të trojeve shqiptare*, e cila me të drejtë mund të quhet një projekt për “spastrim etnik”. Flitet argumentueshëm për shkaqet, rrjedhat dhe ngjarjet që i dhanë mundësi dhe “dorë të lirë” Jugosllavisë për të arritur deri te ky *akt barbar*. Ndër të tjera do të veçoj tri gjëra që më lan përshtypje duke lexuar trajtesën *“Shkodra në marrëdhëniet ekonomike shqiptaro-jugosllave 1922-1939”*.

E para, tipi i shkrimit. E dyta, trajtohet një temë që është prekur edhe në librin e parë, por tema e Shkodrës këtu është trajtuar në mënyrë shumë më të thelluar, ajo tashmë është kryefjalë e punimit. E treta, edhe në rrafshin kohor tema ka një shtrirje më të gjerë se te libri i parë. Pra, nga një njësi e vogël tematike, ajo shndërrohet në një temë më vete që trajtohet me përkushtim. Doemos se pushtimi i Shqipërisë nga Italia e ka preokupuar historiografinë shqiptare dhe historianen Bakalli. “Akt barbar” e quan me të drejtë pushtimin e Shqipërisë nga Italia më 1939. Ajo hap pas hapi e fakton këtë, e argumenton pse pushtimi ishte “akt barbar”. Në këtë kontekst përmend edhe tre opsionet e Italisë për zgjidhjen e çështjes shqiptare së bashku me Jugosllavinë. Ishte Jugosllavia, sipas autores, ajo që vulosi fatin tragjik të Shqipërisë, e cila u ndihmua drejtpërdrejt edhe nga Gjermani, kurse në mënyrë indirekte edhe nga Anglia e Franca. Autorja flet edhe për reagimet e fuqive demokratike perëndimore, të cilat, siç shprehet ajo, më shumë preferonin një kapitullim paraprak të Shqipërisë, se sa të reagonin kundër atij pushtimi. Mirëpo, ishte SHBA-ja ajo që e dënoi këtë invazion ushtarak, duke e quajtur si kërcënim për paqen në botë. Një risi në rrafshin tematik dhe për nga qasja në këtë libër më duket trajtesa *“Gruaja në luftë - kontributi i saj në Brigadën 138 “Agim Ramadani”*. Kjo dëshmon se historiania është marrë edhe me mbledhjen e të dhënave dhe trajtimin e temave që lidhen me Luftën e UÇK-së, me Luftën e Kosovës 1998-1999, madje edhe me rolin e gruas në

këtë rast. Tema jo vetëm se është aktuale, por dhe sfiduese për historinë e historiografinë shqiptare, sepse kjo temë ende është e patrajtuar. Një historiane e angazhuar nuk mund të mos e trajtonte edhe një temë të tillë.

Pjesa e dytë e librit (*“Vështrime dhe refleksione”*) përbën një ndryshim në qasje për problemet që lidhen me historiografinë, me kritikën historike, me çështjet teorike e metodologjike. Trajtesat, kumtesat, analizat dhe vështrimet për personalitete, për ngjarje, për vepra, për çështje teorike e metodologjike, për historinë si objekt e historiografinë si subjekt dhe për mënyrën e interpretimit të dokumenteve, përbëjnë brumin me të cilin përgatit këtë pjesë të librit. Them se nuk është e rastit që kumtesa e parë e kësaj pjese të librit lidhet pikërisht me historiografinë.

Profesoresha Emine Arifi-Bakalli e konsideron të nevojshme të organizohen diskutime, debate e tryeza, ku do të debatohet për çështje të hapura dhe të diskutueshme që kanë të bëjnë me historiografinë shqiptare, me të arriturat dhe të metat e saj. Është kundër atyre pikëpamjeve dhe mendimeve (që përdoren si refrene) se shqiptarët nuk kanë historiografi, se historiografia është në stadin fillestar, se ajo duhet të rishkruhet. Përkundrazi, ajo shprehet se kemi historiografi.

Për të qenë më konkrete e korrekte përmend fazat nëpër të cilat ka kaluar historiografia derisa ka arritur aty ku është. Jep shembuj konkret për ekzistencën e historiografisë, duke përmendur si fakte ekzistencën e monografive dhe të revistave historiografike, por edhe çështjen e periodizimit të saj. Fillesat e historiografisë i gjen në vitet ‘20-‘30 të shekullit XX, kurse bazat e historiografisë së mirëfilltë thotë se u hodhën në vitet ‘50-‘60 të shekullit XX. Edhe pse, sipas saj, historiografia e periudhës komuniste degjeneroi në shërbëtore të politikës, nuk mund të mohohet ekzistenca e saj. Me këtë rast nuk lë pa e përmendur edhe faktin se sa komplekse është të merresh me trajtimin e historiografisë. Prandaj, ajo përmend disa detyra, sfida e pengesa që dalin për historianin dhe historiografinë bashkëkohore. Me këtë rast shtron nevojën e përgatitjes profesionale të kuadrit për përdorimin e metodave të reja shkencore për trajtimin e çështjeve dhe temave. Si parakusht përmendet hulumtimi i ndërgjegjshëm. Në këtë rrafsh veçon një dukuri (arsyeshëm) shqetësuese, e cila mund të shndërrohet (në mos qoftë shndërruar tashmë) edhe në fenomen. Është fjala për përdorimin ose shënimin e arkivave e fondeve nëpër libra pa i hulumtuar fare nga autori. Çështja tjetër shqetësuese

e trajtuar në këtë libër, është fakti se disa historianë bëjnë libra me tekste të kompiluara dhe me to krekosen. Për më tepër, çështja ka degraduar aq shumë sa plagjiatura është bërë modë. Këto e të tjera autorja i ka vërejtur qysh më 2006 (mbase edhe më herët) si të pranishme në historiografinë tonë.

Autorja është kritike edhe për mënyrën se si futen në kalendarë vjetor konferencat, sesionet e simpoziumet shkencore. Statusi i historiografisë nuk mund të mos merrej në trajtim me këtë rast. Historiografia nuk është produkt për konsum të gjerë, shprehet në një rast me të drejtë ajo, sepse historiografinë e konsideron si elitare, sepse çështjet problemore që dalin te ajo i konsideron probleme që mund t'i diskutojnë e zgjidhin vetëm elitat, kjo nënkupton studiuesit, historianët e mirëfilltë, të sprovuar dhe model. Tamam historiane aristokrate. Shqetësuese për të është mungesa e institucionit të kritikës, kritikës së mirëfilltë shkencore. Ajo është për një kritikë të mirëfilltë, të sinqertë dhe të guximshme.

Profesoresha Bakalli ka dhënë shembuj se si duhet t'i qasemi një teme historike, se si t'i qasemi analizës së një dokumenti, një teksti, se si t'i trajtojmë profesionalisht problemet në mënyrë profesionale, pa paragjykime, në mënyrë konkrete e të argumentuar, por edhe me shumë guxim, si dhe me sens kritik e polemik. Njëra prej tyre është trajtesa për Isë Boletinin e cila, për mendimin tim, del të jetë ndër më të mirat, ndër më të plotat jo vetëm te ky libër, por në historiografinë shqiptare. Çështja vështrohet në disa aspekte. E para, ka në fokus një personalitet kombëtar, Isë Boletinin. E dyta, duke folur për Boletinin, ajo flet për karakterin e luftës çlirimtare që udhëhiqej nga Isë Boletini, Ismail Qemali, Hasan Prishtina dhe prijës të tjerë. E treta, duke i dalë në mbrojtje I. Boletinit nga ata që janë përpjekur ta etiketojnë, madje duke e quajtur tradhtar, në fakt i del në mbrojtje gjithë krerëve të Lëvizjes Kombëtare, vetë Lëvizjes. Kësisoj tregon guximin e saj intelektual në mbrojtje të figurave historike, siç ishte Isa Boletini, por edhe përgatitjen e saj profesionale dhe personalitetin e saj. E katërta, duke e mbrojtur Isë Boletinin, mbron dhe popullin shqiptar dhe luftën e tij të drejtë e çlirimtare. E pesta, godet fort historianët diletantë e dyfytirësh që i ndërrojnë pikëpamjet pas çdo shujte, pas çdo ndërrimi të pushtetit a sistemit politik; i godet ata që shkruajnë libra (madje edhe monografi) me porosi e miqësi për interesa të ndryshme. Si emra konkret veçon Tahir Avdylin, Hakif Bajramin, Muhamet Pirrakun dhe ndonjë tjetër. Me këtë trajtesë autorja synon ta harrë (shkul) barin e keq që ka

mbirë në historiografinë tonë. E gjashta, duke e mbrojtur kontributin dhe rolin e tribunit Isë Boletinit, ajo mbron të vërtetën nga gënjeshtarët, e mbron historiografinë nga pseudohistorianët. Nuk mund të mos pajtohemi me mendimin se *“imazhi për Shqipërinë (dhe shqiptarët-M.K.) që krijohet nga këto shkrime (dhe nga disa autorë-M.K.) është tepër i shëmtuar”*. Me shkrimin për Isë Boletin, nxjerrë në sipërfaqe shumë të palara, padrejtësi, absurditete e paradokse me të cilat përballet historiania dhe historiografia shqiptare. Sepse qëllimi i historianëve të tillë, siç shprehet autorja ajo është: *“denigrimi i një epoke dhe i një varg personalitetesh historike, në radhë të parë Isë Boletinit”*. Dhe kjo ndodhte pikërisht atëherë (vitet ‘90-të M.K.) kur duheshin marrë si modele figurat historike për ta trasuar rrugën për një luftë, siç ndodhi më vonë.

Në vazhden e shkrimeve për personalitete historike, shkencore e intelektuale dhe në përpjekje për të vlerësuar maksimalisht rolin dhe kontributin e penave të shquara të historiografisë, janë shkruar dy shkrime (kumtesa) për një personalitet. Shkrimet janë shkruar në periudha të ndryshme (1993 dhe 2008), por janë përfshirë në libër. Që të dyja lidhen me akademik Ali Hadrin. Që të dyja të lexuara në simpoziume shkencore. Kumtesa e parë flet për rolin dhe kontributin e akademik Hadrit për historinë e Rilindjes Kombëtare, e dyta për profilin dhe shkrimet e tij shkruar për periudhën mes dy luftërave botërore. Se sa e çmon, se sa e vlerëson dhe se sa është e lidhur me këtë personalitet, duke e konsideruar historian model, po i përmendim vetëm dy-tre raste. E para, gjuha (pothuaj himnizuese) që përdor me të dy punimet. E dyta, te kumtesa e parë në 6-7 faqe tekst përmend diku 16-17 herë emrin e tij edhe titullin profesor, kurse te kumtesa e dytë, në 10 faqe tekst, ajo 20 herë e shkruan emrin e tij dhe titullin “profesor”. Pra, gjithsej 37 herë. Të veçanta janë edhe vështrimet për librin e Ovis Pirson me titull *“Shqipëria nën okupim...”* dhe ai për librin e Shaqir Vukajt *“Rusia dhe Kosova-shënime të një diplomati”*. Me këto vështrime autorja bën së paku tri shërbime. E para, vlerëson punën e autorëve. E dyta, i çmon dhe i vlerëson librat dhe vlerën e tyre. E treta, e orienton lexuesin e zakonshëm dhe studiuesin se ku mund të gjejë libra më vlerë që flasin për pikëpamjet për shqiptarët përgjithësisht, veçanërisht për Kosovën, për Kosovën e viteve ‘90-të. Në tri kumtesat e fundit të këtij libri dalin tri çështje, sa aktuale po aq edhe problemore. Tema e kumtesës së parë ka të bëjë me sferën e arsimit, në fakt

me Kurrikulën. Te *“Refleksionet për Kurrikulën e re të Kosovës”* rrok një dimension interesant në sferën e politikave arsimore, ku ka punuar dhe analizuar me përkushtim e entuziazëm, duke e konsideruar si pikënisje të mbarë. Jep dhjetëra vërejtje dhe paralajmëron se duhet të jemi të kujdesshëm në zbatimin e saj. Kërkon të mos bëhen improvizime, sepse kështu do të shkaktohet konfuzion. Vërejtje të veçanta jep edhe për statusin e lëndëve *Gjuhë shqipe* dhe *Histori*. Qysh në vitin 2001 e ka shprehur edhe një shqetësim të saj lidhur me përkufizimin *“Histori e Kosovës”*.

Kjo, sipas saj, nënkupton një përkufizim mekanik, se përkufizime të tilla i ngjajnë logjikës moniste, se këto bien ndesh me parimet themelore të një shoqërie të hapur e demokratike³; se shqiptarët e Kosovës nuk duhet të privohen nga njohja e plotë e Historisë së tyre⁴. Në fillim të krijohet përshtypja se tema (për Kurrikulën) e zgjedhur dhe e futur në këtë libër nuk i përshtatet përmbajtjes dhe strukturës së librit, se nuk lidhet shumë me historiografinë, por pasi e lexon bindesh se trajtimi i saj është shkruar dhe botuar në kohën e momentin e duhur, por duket se vërejtjet dhe shqetësimet e saj nuk u morën parasysh. Kjo mund të jetë një nga arsyt e shumta pse arsimi ynë ka degraduar në këtë nivel. Kumtesa e dytë (...) ka të bëjë me çështjen e bashkimit kombëtar me të cilën preokupohet edhe kjo historiane, ndryshe nga disa të tjerë që e kanë lënë anash dhe që kjo temë iu duket e “dalë” mode.

Një shkrim analitik mjaft aktual, i fundit në këtë libër, është ai për Kosovën shtet sovran. Këtu veçohen disa çështje me rëndësi. E para, Kosova dhe synimit e saj për pavarësi. E dyta, faktori shqiptar në Kosovë dhe ai relevant ndërkombëtar i përçarë, i dyzuar dhe dyshues e jo bindës i hyjnë punës në drejtim të bërjes (shpalljes) së pavarësisë, në përpjekje për t'i kënaqur të gjithë nga pak. Këto i sollën ato parimet cenuese për shqiptarët. Katër-pesë parimet që u imponuan nga faktori ndërkombëtar shkelen mbi disa parime të tjera të njohura ndërkombëtarisht e botërisht, vëren autorja. E treta, agresiviteti e grykësia e palës serbe dhe deklarata me synime pushtuese të politikanëve të “moderuar” si kryeministri i Serbisë, Zoran Gjingjiq, të cilat ishin identike me politikën tradicionale serbe. Këto janë disa nga temat, disa

³ Emine Arifi-Bakalli, *Çështje nga historia moderne dhe bashkëkohore shqiptare*, Instituti i Albanologjisë-Prishtinë, 2011, 196.

⁴ Po aty, 198.

nga çështjet problemore të trajtuara në këtë libër (të dytin me radhë), me zell dhe me kredenciale profesionale dhe shkencore. Ky libër pasohet nga një libër tjetër, për shumëçka më i ndryshëm se dy të parat si në qasje, metodologjik, si për ide, koncepte, kompozim e strukturë të tekstit, ashtu edhe në rrafshin teorik.

Risi në historiografinë shqiptare

Libri i tretë i historianes, studiueses dhe intelektualet Emine Arifi-Bakalli “*Përballje historiografike*”, botuar nga Instituti Albanologjik, Prishtinë, 2015, sjell risi në historiografinë shqiptare, si në aspektin e studimeve historike dhe në ato të karakterit teorik dhe kritik. Temat, idetë, konceptet, dukuritë e fenomenet, çështjet teorike e metodologjike të trajtuar që kanë të bëjnë me historiografinë shqiptare dhe institucionin e kritikës, kanë zënë vendin kryesor në faqet e kësaj vepre. Ato gjejnë shtrirje në strukturën, kompozicionin, anën formale dhe përmbajtjesore të veprës, lënda e të cilës është sistemuar në disa kapituj dhe njësi tjera... Te kapitulli I (*Shqyrtime, përkufizime, reflektime*) trajtohen çështje me shumë interes, të cilat më herët nuk janë trajtuar sa duhet dhe si duhet. Edhe kur janë trajtuar, nuk janë trajtuar si duhet, nuk janë përkufizuar si duhet, nuk janë emërtuar me emrin që kanë.

Se gjërat duhet të emërtohen me emrin që kanë e përkufizimi duhet të jetë i natyrshëm, flet një ngjarje historike (*Lëvizjen e armatosur kombëtare për autonominë e Shqipërisë e vitit 1912*) me emërtimin, riemërtimin dhe me përkufizimin e të cilës është marrë kjo studiuese. Problematikën e shtron edhe në rrafshin konceptual teorik. Fillimisht për çështjen në fjalë shkruan se ekzistojnë dy taborë, dy pikëpamje, dy grupe të historianëve: ata që këtë Lëvizje e quajnë (e përkufizojnë) *Revolucion* (studiuesit e huaj) dhe, ata që këtë Lëvizje e quajnë *kryengritje* (shqiptarët). Lidhur me përkufizimin “kryengritje” thotë se ka përmbajtje më të kufizuar (është *ad hok*), kurse “*revolucion*”, sipas saj është më gjithëpërfshirës⁵. Edhe pse jep idenë që për zgjidhur këtë çështje duhet kërkuar ndihmë edhe nga gjuhësia, ajo anon dhe pozicionohet kah emërtimi “revolucion”, me arsyetimin se ka të gjitha tiparet

⁵ Emine Arife-Bakalli, *Përballje historiografike*, Instituti Albanologjik, Prishtinë, 2015, 17.

e një revolucion, ngase emërtimi “kryengritje” pëson tkurrje në vlerë, në përmbajtje, në shtrirje në hapësirë dhe kohë. Fatkeqësisht, kjo çështje, siç vëren studiuesja Bakalli, kohëve të fundit ka nisur të tkurret edhe më shumë duke e quajtur madje edhe “Kryengritja e Përgjithshme e Kosovës... e jo e Shqipërisë”, pra edhe më pak se kryengritje shqiptare.

Kjo e shqetëson, e frikëson dhe e revolton autoren. Termi “revolucion”, për të cilin deklarohet autorja, qoftë i drejtë a jo, mund të jetë temë debati, mund të zgjojë kërshërinë për analiza të tjera. Fundja vetëm emërtimi “revolucion” tingëllon si revolucionar. Me ata që e kundërshtojnë këtë, ajo ballafaqohet profesionalisht. Si përfundim, lidhur me këtë, ajo është e prerë në përkufizimin e çështjes. Thotë se *Lëvizja kombëtare* duhet të riemërtohet “revolucion kombëtar”.

Në kuadër të kësaj sintagme, të këtij përkufizimi veçon dy rryma: rrymën autonomiste dhe rrymën funksionaliste. Të dytën e konsideron më të pjekur si ide, si koncept, si përmbajtje dhe si proces. Ide a ideologji, kryengritje e armatosur a kryengritje e përgjithshme (por assesi vetëm kryengritje e Kosovës - M.K.), lëvizje kombëtare a revolucion kombëtar, gjithsecila në një mënyrë a tjetër e ka peshën dhe rolin e vet në një kohë a rrethanë të caktuar. Ato e plotësojnë njëra-tjetrën. Se cila do të zë pozitën e parë në hierarki, se cila do ta merr primatin në hierarkinë e vlerave, se cila do të jetë më praktike, ajo do të ketë statusin e veçantë. Fundja, opinionet, mendimet dhe pikëpamjet për çështjet e trajtuara, opinionet dhe kontradiktat lidhur me përkufizimin e çështjeve në fjalë, flasin se sa komplekse janë çështjet e trajtuara dhe se me sa seriozitet, përkushtim e guxim u është qasur këtyre problemeve teorike kjo studiuese.

Te trajtesa *“Konteksti politik i kryengritjes së Malësisë së Mbishkodrës të vitit 1911: përkufizime dhe refleksime”*, i është kushtuar një hapësirë dhe vëmendje e veçantë *Kryengritjes së Malësisë së Mbishkodrës* (1911), i është kushtuar një kujdes i nevojshëm për rolin dhe peshën e saj në histori. Kjo është e para. E dyta është trajtimi i kësaj teme në kontekstin historik të saj dhe në kontekstin politik të kryengritjes (100-vjetori i saj - M.K). E treta, arsyet pse çuan te kjo kryengritje dhe reflektimi e përmasa e saj. Politika e shtypjes, mungesa e përkrahjes nga Fuqitë e Mëdha dhe politika e pasinqertë dhe jomiqësore e tyre, deklarimi kundër kërkesave të tyre, por

edhe skamja përmenden si disa nga arsyet kryesore që çuan në kryengritje⁶. Autorja është kundër atyre që këtë kryengritje e konsiderojnë të parakohshme, fatale ose komprometuese në planin e përgjithshëm të kryengritjes. Përkundrazi, shprehet ajo, kryengritja *pati rolin e një katalizatori homogjenizues tek shqiptarët dhe e theu mitin e pathyeshmërisë së pushtuesve*⁷.

Në këtë vepër, kjo historiane merret edhe me çështje sociologjike, me çështje të sociologjisë historike, aspekt ky që në studimet tona historike ka një deficit të madh së paku në Kosovë. Duke u marrë me këtë dimension, ajo ka veçuar në këtë rast një kategori shoqërore në shoqërinë shqiptare për kontributin e tyre në raport me kategori të tjera shoqërore. Në këtë rrafsh ajo veçon “fshatarët e lirë” (malësorët - M.K.). Për ta dhe prijësin e tyre (tribunin popullor Isë Boletini - M.K.) ajo ka vlerësim dhe admirim të veçantë, sepse, sipas saj “kjo kategori shoqërore tradicionalisht ishte bartëse e lëvizjeve masive të armatosura dhe prandaj shumë e rrezikshme për Perandorinë Osmane”, ndryshe nga shtresat tjera (e mesme dhe e lartë - M.K.), të cilat nuk ishin në gjendje ta udhëhiqnin kryengritjen (e vitit 1910 - M.K.) që u takonte kur Kosova po e përjetonte golgotën e saj, siç shprehet autorja⁸. Tubimin (Kuvendin) e Ferizajt e vlerëson aq shumë sa konsideron prolog dhe epilog të kryengritjeve 1908-1912. Mbi këtë bazë është shkruar punimi “Ferizaj, vatër e rëndësishme e Lëvizjes Kombëtare Shqiptare 1908-1912”⁹.

Profesoresha Emine Arifi-Bakalli, siç del edhe në këtë vepër, ishte një historiane e pasionuar, një studiuese me koncepte të qarta teorike, e cila ka hulumtuar, analizuar dhe interpretuar me kompetencë profesionale. Asaj i ka mjaftuar gjetja e një dokumenti në ndonjë arkiv të ulej e të shkruante një punim, të bënte një analizë dhe interpretim me shumë rëndësi. Dokumenti i gjetur në Ministrinë e Punëve të Jashtme (MPJ) të Shqipërisë me titull “Unioni Parlamentar Evropian” e ka nxitur të shkruajë kumtesën e radhës: “*Ideja evropiane Kongresi I i Unionit Paneuropa dhe shqiptarët*”. Ky punim mund të konsiderohet si një histori e shkurtër, një sintezë pikëpamjesh, idesh, përpjekjesh për “Unionin Evropian”. Paneuropianizmin të shqiptarët, sipas

⁶ Po aty, 31.

⁷ Aty, 46.

⁸ Aty, 33.

⁹ Po aty, 47-61.

saj, duhet kërkuar që nga koha e Skënderbeut, por edhe të Rilindja Kombëtare. Mirëpo, ishte Konferenca e Ambasadorëve në Londër ajo që i zhgënjeu tej mase shqiptarët, por nuk ua zbehu besimin për qenien evropiane të Shqipërisë. Këtu del në sipërfaqe edhe një çështje interesante: çështjen e raporteve të shqiptarëve me Evropën, për të cilën nuk mund të them se sa ka zënë vend në historiografinë shqiptare. Duke shkruar për një personalitet (siç ishte Hajdar Dushi) që me ide, bindje e koncepte ishte i majtë, ajo sjell opinionin e saj edhe për çështje të tjera që shtrihen përtej temës, që lidhen me ngjarje, epoka dhe ideologji. Sipas saj, kjo ideologji me të cilën ishte brumosur Dushi nuk mund e nuk duhet të krahasohet me nazizmin e fashizmin, ani se komunizmi u shndërrua në diktaturë. Me këtë duket se autorja rekomandon se nuk duhet të shikohet e kaluara nga perspektiva e sotme. “*Një mikrosintezë për Kosovën (1945-1997)* është një punim që në rast të shkrimit të Historisë së Kosovës do të duhej të merrej në konsideratë për disa arsye.

Në kapitullin e dytë (*Vështrime kritike*) që dallon nga i pari, çështjet trajtohen nga këndvështrimi i kritikës historike. Një nga punimet më të gjata të kësaj natyre, në mos dhe më i gjati në këtë kapitull dhe në këtë libër është “*Vështrim kritik për interpretimet rreth “Dokumentit gjashtëmbëdhjetë pikësh” për marrëveshjen autentike Zogu-Pashiq të vitit 1924*”. Këtu, ndër të tjera shtrohen tri çështje kryesore: dokumenti dhe autenticiteti i tij, vështrimi dhe analiza e tij nga historianë të shquar të cilët kanë bërë lëshime serioze dhe, interpretimi i atij dokumenti, duke përfshirë këtu edhe metodat komparative (krahasuese). Duke pasur për bazë këtë vështrim kritik dhe interpretimin e saj mund të themi se autorja, si hulumtuese dhe interpretuese, por edhe kritike e ashpër, hap debat, hap dilema e shtigje të reja për interpretim, por pa frikën se mund t’ua hapë rrugën e polemikave, kritikave dhe sulmeve ndaj opinionit të saj, ndaj vlerësimit e personalitete të saj. Sido që të jetë për historianët fillestarë, të cilët autorja i quan aspirantë, kjo pjesë është një mësim i mirë për ta, para se të bëjnë interpretime të gabuara. Lidhur me marrëveshjen në fjalë sjell disa përfundime. E para, mohon të ketë ekzistuar një marrëveshje 16 pikëshe, e dyta, ajo del në mbrojtje të Ahmet Zogut lidhur me ekzistencën e një marrëveshjeje të shkruar të tij me Pashiqin; e treta, kësaj radhe, pothuaj mohon kategorikisht se Ahmet Zogu ishte tradhtar, se ai tradhtoi. A duhet dhe si duhet të shënohet 100-vjetori i

Revolucionit Kombëtar dhe Pavarësisë Kombëtare? Kjo është pyetja bosht në të cilën jepen përgjigje, jepen ide e shembuj konkretë në trajtesën “*Viti historik dhe sprovues...*”. Te “*Trajtimi i Turqisë moderne në tekstet historike të Historisë së Kosovës*”, vihet theksi te disa çështje me rëndësi të veçantë dhe aktuale. Historiana është kundër atyre që e ndajnë në dysh, e dyzojnë historiografinë shqiptare (të Shqipërisë dhe Kosovës), pra synimi i saj është integrues dhe jo ç’integrues. Ajo është kundër monopolit (nga grup individësh) në përgatitjen e teksteve...; nuk pajtohet me mendimin (dyshimin e disa të huajve) se historianët e Kosovës mund të bëjnë një tekst të historisë që përballon kriteret evropiane dhe botërore vetëm pas 30 vjetësh. Çështjet tjera të zgjedhura për trajtim janë: politika e Turqisë moderne në relacion me Shqipërinë dhe Kosovën 1922-1939; ndërprerja e marrëdhënieve dy herë me Shqipërinë (1928 dhe 1936); Konventa turko-jugosllave për shpërnguljen e shqiptarëve nga trojet e veta në Kosovë (1938); mënyra e sistemit të shqiptarëve të shpërngulur në Turqi nga pala turke; ndikimi (kritika) nga politika e diplomacia në historiografi; fushata frontale kundër historiografisë shqiptare nga pala turke vetëm pse ata e konsiderojnë Perandorinë Osmane pushtuese; reagimi i autores ndaj ministrit të Jashtëm turk, Ahmet Davutogllu, i cili shqiptarët në Ballkan i konsideron si **mbetje osmane**... Këtë **mbetje** autorja e quan “**haxhiqamilizëm**”! Më tutje, ajo jep ide e sugjeron aspirantët, studiuesit e mirëfilltë, por edhe “*Grupet e ekspertëve të Institutit “Georg Eckel”*”; jep përgjigje të duhur në kontekst të kohës e rrethanave politike dhe profesionale. Një përgjigje, një sugjerim të tillë e gjejmë te punimi “*Mungesa e komunikimit të duhur profesional*”, ku nxjerr në pah çështjen se si zyrtarë të lartë ndërkombëtarë evropianë, si Erhard Busek, kërkojnë t’u jepet hapësirë librave-doracakë për nxënës shqiptarë përgjithësisht, pra edhe atyre në Kosovë, ndërkohë që librat në fjalë i fyejnë shqiptarët, kurse Kosovën as nuk denjojnë të thonë se ka ekzistuar a ekziston. Ajo deklarohej kundër që librat e tillë t’u serviren atyre. Kjo është edhe një dëshmi se çfarë librash (“bërllog”) janë servirur (në vitin 2005) e serviren për shqiptarë në Kosovë e Shqipëri në shek. XXI nga zyrtarë dhe “ekspertë” evropianë, ndërkohë që historianët, studiuesit e fushave përkatës as që kanë denjuar (mbase as kanë guxuar) të merren me to. Kapitulli III (*Dokumenti historik dhe interpretimi i tij*) është në interes, prandaj kërkon vëmendje dhe përkushtim për lexim e rilexim. Ky kapitull, kjo pjesë nis me dy dokumente të një atasheu ushtarak jugosllav për

gjendjen në Shqipëri dhe “*veprimtaria efektive subversive në Shqipëri*” e jugosllavëve¹⁰. Dy Elaboratet, Memorandumi (1) dhe dy-tre letra, janë tre dokumente historike në të cilat e ndërton interpretimin e saj autorja në këtë pjesë a kapitull. Shkrimi “*Një memorandum i Bedri Pejanit drejtuar O.N. Chamberlain për fatin e Shqipërisë*” tërheq vëmendjen për lexim jo vetëm sepse flitet për Bedri Pejantin si personalitet i kohës, jo vetëm se flitet për memorandumin që ai i shkruan Çemberleinit, por edhe për faktin se Memorandumi publikohet i plotë, se është në interes të lexohet e trajtohet nga aspekte të ndryshme.

Kapitulli IV (“*Intervista tematike dhe prezantime*”) për mua përbën një risi. Më duket rast i rrallë, i veçantë dhe i munguar, kur në një libër historiografik, në strukturën e tij futet edhe intervista si zhanër publicistik, që trajton një temë historike që i shërben historiografisë. Risi edhe për faktin se në këto intervista (dhënë shtypit të kohës përgjatë viteve ‘90-të të shek. XX deri më 2010) jepen opinione, pikëpamje e qëndrime të veçanta për personalitete, për ngjarje, për historinë e historiografinë; për çështje teorike e kritike; për zhvillimet ekonomike, politike e diplomatike të shtetit shqiptar në krye me Ahmet Zogun; për raportet, marrëveshjet dhe acarimet mes Shqipërisë e Italisë dhe mes Shqipërisë e Jugosllavisë, disa prej të cilave i lexojmë për herë të parë. Me anë të këtyre intervistave synim parësor i saj është të na “*ofrojë të vërtetën historike e jo të na largojë nga kjo e vërtetë*”. Libri “*Përballje historiografike*” përfundon me dy letra e fjalë rasti (kumtesa a vështrime) për dy libra, por edhe me një temë për “*Rolin e gruas kosovare në paqe dhe në luftë*”, që në njëfarë mënyre është vazhdim a plotësim i kumtesës “*Gruaja në luftë-kontributi i saj në Brigadën 138 “Agim Ramadani”*”.

Se me sa mund edhe me sa përkushtim e profesionalizëm është shkruar e përgatitur ky libër dëshmojnë më së miri problemet që trajton, sfidat e sulmet me të cilat ballafaqohet, burimet arkivore të pabotuara, dokumentet arkivore të publikuara, shtypi dhe literatura historiografike, që përbëjnë hiq më pak se 26 faqe. Te këto tre libra bien në sy edhe çështje tjera që kanë të veçantat dhe të përbashkëtat e tyre. Një element përbashkues e konsideroj trajtimin e disa temave, pra aspektin tematik. Ka tema të caktuara që gjejnë

¹⁰ Po aty, 228.

hapësirë e shtrirje në të tre librat. Dhe në të tre rastet jepet diçka e re, ka plotësime në temë, në argumentim e në qasje. Ja shembujt konkretë. Shkodra është njëra nga ato tema.

Te libri i parë, Shkodra na del si nyje kyçe në marrëdhëniet ekonomike shqiptaro-jugosllave, se edhe pozita gjeografike e saj e imponon një gjë të tillë, por nuk është temë bosht. Nëse te libri i parë nuk përbën temën bosht, në librin e dytë (Shkodra) na del temë më vete, pra një nga temat e shumta. Shkodra shpërfaqet si temë edhe në librin e tretë, por në një kontekst tjetër. Kështu autorja duke folur për kryengritjen e Malësisë së Mbishkodrës doemos prek edhe Shkodrën dhe rolin e saj historik në çështjen kombëtare. Përveç Shkodrës është Isë Boletini ai, i cili trajtohet si temë kryesore, si (nën)kapitull libri, në dy librat e fundit. Edhe akademik Ali Hadri, si një nga emrat më të shquar në historiografinë shqiptare për të cilin janë shkruar dy shkrime, që natyrisht e plotësojnë të njëjtën temë, e plotësojnë profilin krijues e profesional të Hadrit. Shkrimet për Hadrin janë të shkruara me shkas, edhe pse në dy periudha të ndryshme kohore.

Te shkrimet për këto dy personalitete, autorja tregon dhe dëshmon respektin e veçantë që ka për këto dy figura; shkrimet kanë vlerën, thellësinë, qartësinë, argumentimin, edhe gjuhën profesionale shkencore për admirim për nga mënyra se si u është qasur. E treta, studiuesit si A. Hadri i japin format të ri historiografisë, kurse figura e Isë Boletinit e trajtuar si duhet e ruan përmasën kombëtare dhe karakterin çlirimtar të luftës për liri e pavarësi kombëtare që u arrit më 1912. Trajtesa për Isë Boletinin duhet rilexuar dhe mbajtur mend, sepse nxjerr shumë të palara, shumë naivitete të disa historianëve. Edhe Ahmet Zogu trajtohet si temë në tre librat e saj, por në kontekste e rrethana të ndryshme. Autorja e vlerëson kohën kur Zogu, sipas saj e qeverisi Shqipërinë, ani se *de fakto* Shqipëria qeverisej e sundohej nga Italia. Ndërkaq duke folur për pushtimin e Shqipërisë nga Italia përmend dobësinë e Zogut, i cili “... nuk e pa të udhës dhe as që e mbajti premtimin se do “të mbathte opingat” dhe të dilte në mal (në rast se e sulmonte Italia - M.K.). Përkundrazi, ai u ul në automobil dhe iku” me mercedesin (mercedes cabriolet-lux), të cilin ia kishte dhuruar Hitleri me rastin e martesës së mbretit Zog. Për pasojë rezistenca kundër Italisë ishte e vogël, ishte minore. Rezistenca ishte aq minore, sepse nuk kishte as një brigadë të gatshme për t’iu kundërvënë pushtimit italian. Sepse, se “sikur shqiptarët të kishin pasur

një brigadë të armatosur mirë do të “na hidhnin në det”, do të shprehet Anfusus ish-komandant i forcave italiane.

Pra, ushtria shqiptare pothuaj ishte e shpërbërë dhe kishte dalë nga kontrolli i A. Zogut, atë po e *kontrollonte Italia* edhe para se të niste pushtimi. Dhe pjesa kryesore e fajit rëndon mbi prijësin, mbi Ahmet Zogun. Kjo dëshmon se Shqipëria ishte një shtet i brishtë që mezi mbijetonte. Përkundër këtyre lëshimeve, përkundër këtyre të metave e gabimeve të Zogut, autorja e vlerëson “kohën” e Ahmet Zogut dhe qeverisjen e tij, duke pohuar se ishte kohë e një “emancipim ekonomik dhe emancipim politik”. Ajo mohon se Zogu ia kishte dhënë Jugosllavisë nën sundim Shën Naumin dhe Vërmoshin, sepse, sipas saj, Jugosllavia i kishte ato nën sundim. Ndërkaq duke folur për ndihmën që dha Jugosllavia për rrëzimin e Qeverisë së Nolit për ardhjen në pushtet të Zogut me ndihmën e Beogradit, shkruan se nuk ishte Jugosllavia e vetmja që e solli Zogun në Shqipëri. Ishte *faktori i jashtëm për arsye të caktuara që luajti rolin vendimtar e sidomos qëndrimi britanik*. Një respekt të madh autorja ka për Nolin. Nolin e vlerëson në superlativ. Qeverinë e Nolit e quan “qeveri demokratike”, kurse Nolin e quan “demokrat të rangut botëror”. Ajo shprehet se “kundër qeverisë së Nolit u organizua një komplot ndërkombëtar”, prandaj Qeveria e tij ra¹¹, për pasojë Noli u detyrua të arratiset. Si risi në rrafshin tematik e konsideroj edhe trajtimin e temës së luftës së UÇK-së, por edhe temën pjesëmarrjes dhe rolin e gruas në radhët e kësaj organizate.

Edhe pse e kam njohur si mësimdhënëse, sepse i kam ndjekur pothuajse rregullisht leksionet e saj në nivelin baçelor dhe master, nuk më kujtohet, nuk mbaj mend ndonjë reagim të saj emocional, ndonjë reagim a shprehje revolte në raste kur kishim opinione, mendime e pikëpamje të ndryshme nga ajo lidhur me ndonjë tema. Mirëpo, reagime emocionale, me një dozë të theksuar revolte kam hasur gjatë leximit të ndonjë shkrimi të saj të botuar në gazeta e revista, bile edhe në ndonjërin nga veprat e zgjedhura për trajtim. Pra, ka pasur raste kur prof. Emine Arifi-Bakalli, gjatë trajtimit të ndonjë teme në shkrimet e saj ka reaguar me dozë emocionale, duke demonstruar edhe karakterin e saj polemizues, duke shprehur revoltën e saj me një diskurs, me një fjalorë e një gjuhë që nuk e hasim shpesh. Shembull

¹¹ *Përballje historike*, 282.

konkret kemi trajtesën për Isë Boletinin. Autorja revoltohet dhe shpreh mllefin e saj në këtë mënyrë: “*vaj medet për Isën e për mua që jam e detyruar të merrem me këto shkrime*”; sepse ... *akuza më të paskrupullta, më të padrejta; “pamje (më) makabre, akuzë më morbide...nuk mund të paramendohen*”. Ky fjalor edhe mund të “arsyetohet” në një masë, kur dihet koha kur është shkruar shkrimi, kur është shkruar trajtesa (1991), por një studiueseje dhe intelektualeje nuk i shkon shumë për shtati një “ton” i tillë.

Të tre librat bien në sy edhe për një fakt tjetër: për titujt dhe nëntitujt e librave, kapitujve e nënkapitujve, por edhe për fusnotat. Më duket se fusnotat janë pak ca të ngarkuara me sqarime, kurse te titulli i librit të parë kemi një “lëshim” gjuhësor në titull: në vend se të shkruhet “marrëdhëniet” është shkruar “marrëdhënjët”. Pavarësisht këtyre “gabimeve” krejtësisht të papërfillshme në krahasim me vlerat, veprat e saj veçohen edhe për fjalorin e pasur, për fjalët (leksikun), sintagmat, shprehjet e veçanta. Fjalët (leksiku), sintagmat, shprehjet e terminologjia që ajo ka përdorur, në disa raste i japin ngjyrim eseistik i librit, herë-herë edhe ngjyrim emocional, por edhe të rrjedhshëm për t’u lexuar.

Në diskursin e saj janë të pranishme epitetet, krahasimet, simbolet, metaforat, por edhe shprehjet dhe fjalët e urta popullore: *bard, korife, kolos kombëtar, gjeneral legjendar, neologjisti Nol, shqipëriprishës, shekull i dritës, thembër Akili, Kutia e Pandorës, Shpatë Demokleu, periudhë e artë, një të rame e dy të vrame, fshatarët e lirë, ballkanofil; gjenocid klasik, tipar demokratik, Ballkani revolucionar, nacionalizëm agresiv, rrymë funksionaliste, rrymë e pjekur politike, puro luks, politikë demagogjike, bashkimnxhinjve, revolucion nacional, periudhë e artë, realpolitika shqiptare, tehu antiturk, terriore të shkreta, tregti të shëmtuar me njerëz, shteti shqiptar i projektuar nga Fuqitë e Mëdha, shteti viable, qytete-tregje (Shkodran, Peja, Prizreni); konsumator relativ, konsumator të përherëshëm; historiografi cilësore e imponuese; frymë relativizuese-liberale; homogenitetet ideologjik; zbehje e shablloneve në kokat tona; krizë kronike ekonomike; elaborat monstruoz; “konglomerat shtetesh”; konglomerat interesash; nën zhguallin e lirisë; nacionalizimi agresiv vullgar; pozicione rigide; terminologjia.. nuk dorëzohet lehtë; fshatarë të lirë, pacifistët evropianistë; luftë qytetare evropiane; intermexo paqësor; prejardhje komplekse entike; përkufizim mekanik; logjika emancipuese; masa*

drakonike; komuniteti historiografik; trendi terminologjik; qarqe kompradore; logjika e shërbëtorit apo profiterit; të krisurit e Beogradit; lideri i lideres botërore; traktati shqipëriprishës (Traktati i Fshehtë i Londrës) etj. Ky fjalor, ky diskurs, kjo gjuhë, siç thamë, i jep ngjyrim eseistike librave, por nuk cenon vlerën shkencore të tyre. Konsideroj se ky ngjyrim, kjo gjuhë deri diku eseistike nuk e dëmton, por e bën më tërheqëse leximin. Sepse, autorja, nuk mbetet robëreshë e frazave të thata. Varësisht temave të trajtuara, tipave të shkrimit dhe kohës janë shkruar dhe botuar veprat, diskursi ligjërimit ndryshon, pasurohet vazhdimisht me leksik (fjalë), sintagma e shprehje, duke sjellë risi në këtë aspekt, por edhe në rrafshin formal e përmbajtjesore, në ide, në koncepte e qasje. Edhe pse janë trajtuar tema e çështje të ndryshme dhe shumë komplekse, ato janë vënë në shërbim të dy çështjeve kryesore: historisë dhe historiografisë.

Përkushtimi i madh dhe gatishmëria për të hulumtuar me dekada nëpër arkiva e institucion tjera të kësaj natyre, për të sistemuar, analizuar e interpretuar çështje të rëndësishme dhe komplekse për historiografinë, madje, kur e kur, duke hapur debat e duke u ballafaquar (në formë kritike e polemike) me autorë e vepra, gjithnjë në përpjekje për të nxjerrë në shesh të vërtetën, e bëjnë këtë studiuese dhe intelektuale të veçantë e ndryshe nga disa të tjerë. Përpjekjet e saj për të dhënë ide, për t'ju qasur problematikës që trajton me koncepte e ide të reja e të avancuara, krejt kjo me qëllim dhe në funksion të avancimit dhe ngritjes në pedestal meritore të historiografisë shqiptare, bëjnë që për këtë autore ta kemi respektin e konsideratën që duhet ta kemi si për çdo studiues të mirëfilltë, pavarësisht mendimeve, qëndrimeve, ideve e koncepteve që mund të mos përputhen në ndonjë rast. Por, fatkeqësisht, jo çdo herë është treguar respekti i duhur për të. Në këtë mënyrë është shkelur etika profesionale, është ngulfatur mendimin kritik dhe i ndryshëm, është marginalizuar alternativën e re në historiografinë shqiptare. Nga ky zë i veçantë, nga kjo alternativë e ky mendim teorik e kritik i ndryshëm nuk duhet të kemi frikë, por duhet të mësojmë, sepse vetëm kështu e kultivojmë mendimin kritik, e konsolidojmë institucionin (e munguar) të kritikës historike.

Duke pasur për bazë shkrimet që kam lexuar (nëpër gazeta dhe revista) dhe veprat që kam zgjedhur për trajtim, mendimi im është se profesoresha, historiania dhe intelektualja prof. Emine Arifi-Bakalli,

shpërfaqet dinjitetshëm në historiografinë shqiptare, në studimet tona historike dhe historiografike, del si një zë i veçantë, shpesh i ndryshëm dhe si alternativë në historiografi pa të cilën historiografia shqiptare do të disonojë. Pavarësisht se ajo nuk është më fizikisht në mesin tonë, janë veprat e saj. Ato janë personaliteti, janë formati i saj intelektual. Ato e mbajnë të gjallë atë. Me veprat e saj ka lënë gjurmë në historiografi. Gjurmë, sepse krizës së ideve u ka shërbyer me ide të reja, disa koncepte të paqarta i ka emërtuar me emrin që kanë, përkufizimeve të paqëlluara e të padrejta u ka vënë fre, por edhe ka dhënë kontribut në ngritjen e institucionit të kritikës historike për të cilën kemi aq shumë nevojë.

Pra, edhe institucionit (të pakonsoliduar) të kritikës historike, sidomos në Kosovë, i ka bërë një shërbim të mirë në drejtim të konsolidimit dhe funksionalizimit të saj. Me këto dhe të tjera shërbime, ajo i ka bërë një shërbim të madh historiografisë shqiptare. Kurse me punën dhe angazhimin e saj si pedagoge shumëvjeçare vetëm sa e ka ngritur cilësinë e studimeve në UP. Nuk janë të paktë ata që kanë folur dhe shkruar për një pedagoge me principe e parime e kritere të qarta dhe korrekte, për një studiuese e shkencëtare që i ka dhënë Universitetit e shkencës së historisë, por as nuk kanë munguar të tillët që nuk e kanë vlerësuar sa duhet kontributin e saj si pedagoge dhe si intelektuale. Shkuarja në amshim e saj është një humbje e madhe për historiografinë, është një mungesë që nuk mund të kompensohet.